



**"EKSTREMIZMI BURON
NGA KEQLEXIMI I FESË!"**



MBURRAVECË...!?



**SHQIPTARËT E (PA)NJOHUR
NË SHTETIN OSMAN**

Viti XIV - Nr. 2 (156),
Shkurt, 2016

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

*E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative*

"ISLAMI - MESAZHI I MËSHIRËS DHE I PAQES PËR MBARË BOTËT"

"Tema e ekstremizmit a mesatarizmit, si dy koncepte diametralisht të kundërta me njëra-tjetrën, lidhet në zanafillën e saj me sjelljen dhe prirjen morale e shpirtërore të secilit. Dmth, një individ i edukuar, i ruajtur, i kulturuar, është e vështirë të devijojë në ekstremin e keqpërdorimit të teksteve fetare. Këtë e vërteton edhe realiteti i shumë të rinjve të pashkolluar e të paformuar intelektualisht, që duke u lidhur pas një boshti të caktuar argumentesh dhe faktesh të keqlexuara fetare, nisin dhe e dëshmojnë fenë në aparenca dhe lëvizje, që i bëjnë të dallueshëm nga të tjerët. Të mbyllur, të ngurtë, të ngrysur, të gatshëm për të kundërshtuar, të pamundshëm për të toleruar, të nxituar, me pak fjalë, ekstremisht të paformuar!"



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të gjitha falënderimet e plota dhe madhështia absolute i takojnë vetëm All-llahut të Madhëruar në qiell e në tokë, Zotit të vetëm të botrave, i Cili na tërheq vëmendjen në Kur'anin Famëlartë drejt mbikëqyrjes së Tij në jetë dhe turpit, teksa thotë: “A nuk e di ai (njeriu) se All-llahu e sheh?”¹

Salavatet dhe selamet më të përzemërta ia dërgojmë sot në këtë ditë e në çdo ditë të jetës tonë, zotërisë së bijve të Ademit, Hz. Muhammedit (a.s), që u dërgua për të plotësuar moralin dhe mëshirë për mbarë botrat. Thotë në një prej haditheve të tij: “Besimi është gjashtëdhjetë² e ca degë, më e larta e tyre është “la ilahe il-lall-llah” dhe më e afërta e tyre është largimi i së keqes nga rruga. Edhe turpi është degë nga besimi!”³

TË DASHUR TË PRANISHËM, MOTRA E VËLLEZËR,

Tregohet se një person erdhi tek dijetari i shquar algjerian, Shejkh Atije Mesudi (v. 1989) dhe e pyeti: Zotëria im, dëgjojmë shpesh njerëzit të flasin për gogolin, çfarë është ai? Hoxha, që njihej për zgjuarsinë dhe inteligjencën e tij, ia ktheu: “A ke dëshirë ta shohësh e ta njohësh gogolin?” Personi pohoi. Hoxha vazhdoi: “Hiqe frikën e All-llahut nga zemra jote dhe turpin nga fytyra jote, do të bëhesh ti vetë gogol!”

Në shënimet e tij mbi edukatën dhe moralin e muslimanit, Shejkh

1. Kur'ani, El-Alek: 14.

2. Në një trasmetim tjetër: “shtatëdhjetë e ca”.

3. Transmetuar nga Bukhari.

“A NUK E DI AI (NJERIU) SE ALL-LLAHU E SHEH?”

Muhammed El-Gazali, ndër të tjera thekson se: “Turpi është shenjë e singertë e natyrës së njeriut. Ai zbulon vlerën e besimit dhe masën e edukatës së tij... Islami i ka porositur bijtë e tij të jenë të turpshëm... Ebu Said El-Khudri (r.a) tregon se: “Resulull-llahu (a.s) ishte më i turpshëm se vajza e re në dhomën e saj dhe, kur nuk e pëlqente diçka, e kuptonim nga fytyra e tij”⁴... Dhe kur njeriu e humb turpin e tij, ai humb edhe besën e tij dhe kthehet në një egërsirë...”⁵

Në përkufizimet e ndryshme që i janë bërë turpit, ndër të tjera është thënë se ai është: “Ndalimi përpara krejt gjërave që mendja i sheh si të pështira, që shija i refuzon, si dhe mospëlqimi i çdo gjëje që nuk e pëlqen as Krijuesi, as krijesa”⁶

“Shenjë e turpit të njeriut me njerëzit është edhe respektimi i të drejtave të tjetrit dhe vlerësimi i mirësisë së tij! Fëmija me më të madhin dhe nxënësi me mësuesit e tij, duhet të sillen me edukatë dhe respekt, duke mos e ngritur zërin mbi zërin e tyre, duke mos ecur përpara tyre. Në hadith thuhet: “Jini modestë ndaj atyre që ju mësojnë”⁷...”⁸

TË DASHUR BESIMTARË,

Mesazhi i kësaj jave, lidhet pikërisht me turpin dhe domosdoshmërinë e rikthimit të shoqërisë shqiptare tek ky moral, që duket se dita-ditës po perëndon nga shumë mjedise, shtëpi, individë e institucione!

Kur njeriu nuk e ka më frikë Zotin, nuk ka as turp, nuk ka më as besë, nuk ka më as mëshirë, nuk ka më

as njerzillek, dalëngadalë largohet dhe del nga kornizat që përkufizojnë një njeri normal, me virtyte e vlera, me besim e vullnet të mirë për të ndërtuar, jo për të shkatërruar në jetë!

A e shihni sesi ditë pas dite fëmijët dhe të rinjtë po zhveshën nga turpi, duke folur e vepruar sipas një planifikimi të mirëfilltë të armiqve të moralit, besimit dhe njerzillekut?! A e shihni sesi ditë pas dite rinia shqiptare tërhiqet drejt imoralitetit në të folur, në të menduar e në të vepruar? Ku është turpi në shkollat e vendit tonë, ku fëmijët nuk kanë më respekt për mësuesin, për dijen, për lartësimin në shkallët e dijes dhe moralit? Ku është turpi në familje, kur orët më të shumta fëmijët i kalojnë duke ndjekur emisione e filma, pa asnjë lloj kontrolli, fakt që shkakton heqjen e cipës së turpit nga fëmija dhe i riu, në praninë e të cilit prindi sheh çfarë nuk duhet parë, dëgjon çfarë nuk duhet dëgjuar etj!?

*“TURPI ËSHTË
SHENJË E SINGERTË
E NATYRËS SË NJERIUT.
AI ZBULON VLERËN
E BESIMIT DHE MASËN
E EDUKATËS SË TIJ...
ISLAMI I KA POROSITUR
BIJTË E TIJ TË JENË
TË TURPSHËM...
DHE KUR NJERIU
E HUMB TURPIN E TIJ, AI
HUMB EDHE BESËN
E TIJ DHE KTHEHET
NË NJË EGËRSIRË...”*

4. Transmetuar nga Imam Muslimi.

5. Muhammed El-Gazali, “Khulukul-muslim”, botimi i 11-të, Damask, 1994, f. 169-171.

6. Ahmed Said Ed-Dixhevi, “Itmamu fethil-Khal-lak fi mekarimil-akhlak”, verifikoi dhe plotësoi Alaiddin Zateri, botimi i parë, Damask, 1996, f. 34.

7. Transmetuar nga Tabarani.

8. Muhammed El-Gazali, vep. e cit., f. 173.



"Sa shumë e dëmtojnë fenë disa praktikantë të fesë!? Ndonjëri prej tyre ndjek me korrektësi faljen e namazeve me xhemat në xhami, por ai është i pasjellshëm me gruan dhe fëmijët e tij! Ndonjëri prej tyre mburret me gjatësinë e mjekrës që mban, por mashtron në shitblerjen e tij! Shohim një të mbuluar, që ndjek me përpikmëri ligjëratat e ndryshme javore, por është e pasjellshme me nënën e saj! Shohim një ndjekës të takimeve periodike të edukimit dhe udhëzimit fetar, por që shquhet për thashetheme dhe ndezjen e ngatërresave në mesin e njerëzve! A është kjo feja? Jo, vëllezërit e mi! Origjina e dërgesës së profetit të nderuar dhe qëllimi i saj përmblihet në thënien e tij (a.s): "Jam dërguar të plotësoj vlerat e mirësjelljes!"

Dr. Salahudin A. Keftaro

Damask, Siri

*"SHENJË E TURPIT
TË NJERIUT ME NJERËZIT
ËSHTË EDHE RESPEKTIMI
I TË DREJTAVE TË TJETRIT
DHE VLERËSIMI
MIRËSISË SË TIJ!
FËMIJA ME MË TË MADHIN
DHE NXËNËSI
ME MËSUESIT E TIJ,
DUHET TË SILLLEN
ME EDUKATË DHE RESPEKT,
DUKE MOS E NGRITUR
ZËRIN MBI ZËRIN E TYRE,
DUKE MOS E CUR
PËRPARA TYRE.
NË HADITH THUHET: "JINI
MODESTË NDAJ ATYRE
QË JU MËSOJNË"*

Ku është turpi në gjuhët e shumë të rinjve dhe fëmijëve të kësaj kohe, në gjuhët e të cilëve qëndrojnë si ushtarë të bindur lloj-lloj fjalësh e sharjes, të cilat është turpi t'i dëgjosh, jo më t'i përmendësh? (Dhe, jam i bindur se të gjithë jemi dëshmitarë të kësaj pike)

Në këtë pikë më kujtohet sërish një citim i urtë nga faqet e revistës "Zani i Naltë", ku autori, teksa i referohet degjenerimit të fjalorit të rinisë në vitin 1926, ndër të tjera thekson se: "Të shartë dëfton tri sende, tri sëmundje: 1. Ose njeni që përdorë fjalë të ndyra dhe të liga, është një njeri i lik me zemër të keqe, pa dhimpshuri dhe naltësi shpirti. 2. Ose ka një edukatë harbute i rritun me njerëz pa arsim dhe pa delikatesë. 3. Ose është indiferent, nuk ve re çë thotë, nuk shquen të mirën nga e keqja, rron si një drû, si një dhí e egër, vetëm me lumtërin

e nevojës dhe të dëfrimit t'ultë..."⁹

Është e habitshme kur dëgjon në realitetet e sotme, kur prindi e nxit fëmijën e vet të shajë e të përdorë fjalë nga më të pistat, ndërkohë që qeshet me të madhe, ai dhe krejt të pranishmit, kur fëmija i bindet, pa e ditur se çfarë po nxjerr nga goja, por edhe pa e ditur të gjithë së bashku dëmin e madh që i bëhet kësaj krijese, që mëkohet me mungesën e turpit dhe shqyerjen e perdes së tij që në vitet e para të jetës!

Ndërkohë, ne si besimtarë, familjet e fëmijët tanë, shoqëria e jonë islame, jemi të ftuar ta posedojmë moralin e turpit në jetë; ai nuk është dobësi, as frikë, as mungesë guximi, përkundrazi, kur të humbet uji i fytyrës, as gjaku nuk të ka më asnjë vlerë!

H. Muhammedi (a.s) thoshte se: "Turpi nuk sjell vetëm se mirësi"¹⁰, ndërsa në transmetimin tjetër: "Turpi është krejt mirësi"¹¹ Ndërsa sahabiu i nderuar Hudhejfe ibn ul-Jemani (r.a) thoshte: "Nuk ka mirësi në një njeri që nuk ka turp prej njerëzve!"¹²

NË PËRFUNDIM TË KËSAJ HYTBEJE,

Transmetohet se i dërguari i All-llahut ka thënë: "Kini turp nga All-llahu ashtu si duhet!" Sahabët thanë: "Ja Resulall-llah, ne kemi turp, elhamdulillah!" Tha: "Nuk është kjo! Të kesh turp nga All-llahu ashtu si duhet, do të thotë të ruash kokën dhe çfarë ka kuptuar, të ruash barkun dhe çfarë ka zënë, të kujtosh vdekjen dhe shuarjen! Ai që e do jetën e përtejme, heq dorë nga zbulurimet e kësaj bote! Ai që i bën këto, është turpëruar nga All-llahu ashtu si duhet!"¹³

*(Hytbe e mbajtur
në xhaminë e Tophanës)*

Shkodër, më 22 janar 2016

9. Lumo Skëndo, "Edeb, jahu!", në revistën "Zani i Naltë", nr. 1, Tiranë, gusht, 1926, f. 28.

10. Transmetuar nga Bukhari, nga Umran ibni Husajn (r.a).

11. Transmetuar nga Imam Muslimi.

12. Ahmed Said Ed-Dixhevi, vep. e cit., f. 37.

13. Transmetuar nga Tirmidhiu, nga Ibni Mesudi.



Sheikh Muhamed El-Gazali

Njerëzit e thjeshtë dhe shembujt e tyre prej pseudo të diturve, dinë pak e nuk njohin shumë. Ata nuk e kanë frikë Allahun në atë që dinë. Madje, mund të bëjnë edhe gjynah me të, duke nxitur fitne (trazira)!? Ndoshta kjo është ajo që e ka nxitur Ebu Hamid El-Gazalin të shkruajë librin e tij “Pengimi i masave (njerëzve të thjeshtë) prej filozofisë”.

Përse këta njerëz nuk i perfeksionojnë zanatet, prodhimtaritë e mundshme të tyre dhe të bëjnë mirë mjekimin e defekteve të përhapura, në vend që të merren me fetva e të llafllozojnë pa pushim?

Ajo që njerëzit kanë nevojë, prej dispozitave të sheriatit, nuk është diçka e vështirë. Ajo është e paktë prej së lehtës, pastaj atë e përfshin singeriteti, aktiviteti dhe dashuria për rregullim, e atëherë gjërat ndreqen. Gjysma e pseudo të diturve, apo një e dhjeta e tyre, duan të mburren me atë që zotërojnë, me gjithë cektësinë e saj, ashtu siç nxisojnë të përuhin të tjerët e t'i

MBURRAVECË..!?

Ymeti islam përballet me ditë të zymta dhe armiq dinakë të zgjuar, prandaj a t'i takojmë me burrat tanë të mençur, apo t'i vendosim punët tona në duart e barinjve e dhjetëra pseudo të diturve për të na udhëhequr drejt gremisë?

shfaqin si njerëz me njohuri të pakta.

Po i flisja disa njerëzve dhe, njërit prej tyre i thashë: O *zoti* filani, çështja është kështu e ashtu...

Ai nxitoi duke më thënë: O *zoti* filani, ky është shirk! Zoti është Allahu!!

Menjëherë iu përgjigja: Zoti absolut mbi tërë botët është Allahu, nuk ka dyshim, ashtu si dituria e plotë i takon Atij, i lartësuar qoftë Emri i Tij. Kjo nuk pengon, që mes njerëzve të ketë dijetarë, e Kur'ani e ka përdorur fjalën “zot” në përshkrimin e Jahjasë (a.s): “Dhe zotëri, të dëlirë dhe profet prej të mirëve”¹. Dhe në përshkrimin e bashkëshortit të gruas, në ndodhinë e Jusufit (a.s): “E ia behu zotëria i saj në derë”².

Dhe, i Dërguari i Allahut e ka përshkruar Hasen ibn Aliun (r.a) duke i thënë: “Biri im ky, është zotëri...”!

E, i ka thënë fisi Euvs, kur po vinte Sead ibn Muadh (r.a): “Ngrihuni në këmbë zotërisë suaj”.

Ti, o zotëri, ke mësuar një gjë dhe nuk di shumë gjëra. Ti ke oreks të fyesh njerëzit dhe, edhe nëse je i saktë, Allahu nuk do ta pranojë prej teje, derisa të jesh i sinqertë me Zotin tënd dhe të mësosh edukatën!

1. Kur'ani, Ali Imran: 39.

2. Kur'ani, Jusuf: 25.

Në fushën e fikhut islam, ku ndryshimet janë det pa breg, kam gjetur këtë lloj njerëzish, që mëson disa dispozita dhe kërkon të debatojë e të dalë mbi të tjerët. Shtrin gjuhën me fyerje ndaj disa imamëve të mëdhenj, pa pasur nderim për asnjërin, që kundërshton atë çfarë ai njeh!

Unë e fali sabahun pas imamëve që bëjnë kunutin dhe pas imamëve që nuk e bëjnë kunutin, duke ditur se të katër imamët e mëdhenj kanë ndryshuar në këtë sunet; Maliku dhe Shafiu bëjnë kunut, ndërsa Ahmedi dhe Ebu Hanife, jo. Polemika është e lehtë, ndërsa mbyllja e xhamisë, për mua, është më e lehtë se sa zgjidhja e këtij problemi me shklop.


Ymeti islam përballet me ditë të zymta dhe armiq dinakë të zgjuar, prandaj a t'i takojmë me burrat tanë të mençur, apo t'i vendosim punët tona në duart e barinjve e dhjetëra pseudo të diturve për të na udhëhequr drejt gremisë?

Disa, që i përkasin Islamit, i bëjnë zullum atij me mungesën e të kuptuarit të tyre dhe refuzimin që bëjnë për të pyetur njerëzit e dhikrit (dijes), prandaj a po e shpejtojmë dështimin shkatërrues me këtë fanatizëm?

Përktheu nga arabishtja:

Lavdrim Hamja

DISA, QË I PËRKASIN ISLAMIT, I BËJNË ZULLUM ATIJ ME MUNGESËN E TË KUPTUARIT TË TYRE DHE REFUZIMIN QË BËJNË PËR TË PYETUR NJERËZIT E DHIKRIT (DIJES), PRANDAJ A PO E SHPEJTOJMË DËSHTIMIN SHKATËRRUES ME KËTË FANATIZËM?



Xhahid Bushati, shkrimtar

Kohë më parë, me shumë dashamirësi, më ke kërkuar të shkruaja diçka për babanë tim, Hysniun. Më saktë më ke kërkuar, si e njoha unë atë.

Nga kërkesa jote, Miku im, vërtetë, ka kaluar goxha kohë..., por jo kohë e humbur...

Ndoshta, një çast, miku im, ke menduar se e kam harruar porosinë tënde, dhe siç e ke në natyrë, nuk ma ke përsëritur dhe më ke lënë në heshtjen time..., por jo duke menduar për heshtjen time. Se në çaste heshtjeje dhe vetmie shpesh e kam "biseduar" me veten time. Në këtë bisedë, më beso, jam përpjekur të reflektoj. Kështu, pra, miku im, jo vetëm që s'e kam harruar, por porosia jote më sjell në memorien e kujtesës sime vite me çaste trishtimi e dhembjeje, me rrëkeza lotësh, me ëndrra të parealizuar e të vrara...

Më sjell vite malli. Vetë porosia jote, i dashur mik, është kthyer në mall të përvëlur dhe zë një vend shumë të rëndësishëm e të çmuar në jetën time. Është peng për prindin tim, që vetëm fëmijëria ime u çmall me të. Atëhere isha në klasën e tetë. Mësuesi im kujdestar, i nderuari dhe i dituri Gaspër Ugashi, që e kishte njohur mirë babanë tim, duke iu dridhur buza tha para klasës: "Ta doni Xhahidin! Më shumë se kurrë ka nevojë për ngrohtësinë tuaj. Mbeti dy herë jetim. Herën e dytë humbi babanë. Ia kam njohur babanë Xhahidit. Gëzonte respekt! Vetëm respekt gëzonte!"

Më pas, i dashur miku im, vitet që erdhën pas më bënë që të mbështetesh fort në gjoksin e nënës sime të shtrenjtë. Babai ishte kthyer

NJË LETËR MIKUT TIM...

- Më ke kërkuar një shkrim për babain... -

në mall të pashuar...

Këto desha të thosha, si për fillim, për të më kuptuar, se porosinë tënde, mik i dashur, nuk e kam harruar.

E për të ardhur deri në bregun shpresë realizuar, ndoshta edhe mund të çuditësh, por më kanë munduar shumë pikëpyetje. Këto kanë rrjedhur nga disa arsye, që unë do t'i paraqes në këtë letër që do ta dërgoj së shpejti.

Në fillim dua të them se është e vështirë por jo e pamundur të shkruash për prindin tënd që e ke dashur shumë dhe të mungon. Është gjithashtu delikate, por edhe kjo kapërcehet me sineritet e realizëm, pra, me një kontratë ndershmërie që unë i kam bërë vetes me letërsinë.

Dhe pas kësaj paranteze, dua të hidhem në arsyet e mia që më kanë munduar e që më mendojnë edhe sot.

Vitet e punës si gazetar më kanë bërë që të ndjek në vijimësi shtypin periodik, përfshirë këtu edhe atë islam që botohet në Shqipëri, si dhe librat që botohen herë pas here me këtë përmbajtje. Por duke qenë mësues në Medresenë "Haxhi Sheh Shamia" kjo lidhje është më e afërt, më e vëmendshme dhe e shoqëruar me shënime përkatëse në formën e përshtypjeve vetiake, përshtypje që kam dëshirë t'i them dhe ty, i dashur mik..

1-Kam vërejtur në disa shkrime e në disa libra (është fjala për jetëshkrime dhe portrete), kur shkruajnë bijtë për prindin apo për gjyshërit, ose edhe të afërmit për to, kërkojnë si e si lavdinë e jetës së personazhit të shkrimit t'ia rritin aq shumë sa mund të konkurojë me kullën Ejfel. Historia dhe lavdia nuk kanë nevojë për fjalë të bukura, epitete të një pas njëshme, hiperbolizime e ku di unë se çfarë. Historia dhe lavdia kanë nevojë për saktësi, drejtësi, ndershmëri, realizëm dhe në fund "... atë që i takon Çezarit t'ia japim Çezarit". Gjithashtu kam vërejtur se personazheve të



HYSNI H. BUSHATI

shkrimeve u japin kurora dafine të pamerituara, veçanërisht kur ata për shumë vite janë anatemuar ose nuk ka guxuar kush t'i zërë në gojë. U është shumëfishuar lavdia, sipas tyre, e munguar. Kjo është një rrugë pa lavdi, sepse saktësia historike mungon. Mungon se ia ka mbyllur gojën "dryni" i lavdisë, i fjalëve pa kursim që në këto raste është e papërgjegjshme, shpërdorohet pa kriter dhe i ngjan një lumi të turbullt e që tashmë ka dalë nga shtrati dhe nuk njeh kufij...

Pra, këto ishin disa nga arsyet që ende më mendojnë.

Tani po vijmë tek ajo pjesa që unë e quaj më të "vështirën", duke plotësuar edhe kërkesën tënde, një kërkesë që unë patjetër duhet ta bëj. Sepse Ti, miku im i shtrenjtë nuk flet më në emrin tënd, por me emrin e studiuesit, që në Shqipëri, realisht janë pak, dhe në fund të fundit ju keni projektet tuaja, projekte që duhen nderuar e respektuar.

Të jesh i bindur Miku im, që porosinë do ta kryej... Se vitet do t'i thërras dhe kujtimet do t'i thërras...

Të përshëndes, Xhahidi



Mufid Yuxsel, sociolog - Turqi

Takimi ose njohja e parë e osmanëve me shqiptarët zgjatet gjer para Luftës së Kosovës, në periudhën kur Timurtash Pasha zhvilloi fushata në tokat shqiptare, duke filluar nga zona e Dibrës në vitin 785 h /1383.

Veçanërisht pas Luftës së Kosovës, në periudhën e Sulltan Bajazitit, zonat jugore të Shqipërisë hynë nën kontrollin e Shtetit Osman, kurse në kohën e Mehmet Çelebiut, disa bejlerë shqiptarë pranuan Islamin. Disa krahina, si Përmeti, Mirdita e Dukagjini, ishin nën administrimin e princërve të vegjël shqiptarë. Në këtë periudhë, nuk njihet ekzistenca e një sundimtari të fuqishëm në zonë. Beu i parë shqiptar i njohur si mysliman ishte Jakup Beu, biri i Teodor Muzakës, sundimtarit të Përmetit.

Ndërkaq, edhe pse u organizuan marshime dhe sulme të ndryshme për në tokat shqiptare, qoftë me ushtarë nën komandën e Timurtash Pashës, qoftë nën komandën e Isa bej Evrenozit, vendosja e osmanëve në këto troje u bë me marshimet e Sinan Pashës në vitin 1431. Duke filluar nga koha e Mehmet Çelebiut, realizohet edhe shkrimi i historisë së zonës. Defteri historik i vitit 835 h /1432 (Defter-i Sancak-ı Arvanid / Defteri i Sanxhakut të Shqipërisë)¹ është dokumenti më i vjetër që kemi në dorë mbi këtë çështje. Kjo datë është koha kur osmanët u vendosën në këtë zonë.

Kur Shqipëria u mor plotësisht në

1. Defteri i Sanxhakut të Shqipërisë, i vitit 835 hixhri, përgatitur nga halil İnalçık, botimet TTK, Ankara.

SHQIPTARËT E (PA)NJOHUR NË SHTETIN OSMAN

fillim të periudhës së Muratit II, princi Gjoni Kastrioti ia deklaroi sulltanit osman vartësinë dhe, për t'ia treguar besnikërinë, katër djemtë i dërgoi për t'u arsimuar në Sarajet e Edirnesë, që ishte në atë kohë kryeqendra e osmanëve.

Atëherë, djali më i vogël dhe më energjik ndër katër vëllezërit, Gjergj Kastrioti, i pëlqeu sulltan Muratit II dhe meritoi shumë komplimente të tij. Ashtu si vëllezërit e tjerë, si mysliman, mori emrin Skender. Duke e mbajtur atë mes vëllezërve, Muratit II tregoi kujdes të veçantë për arsimimin dhe edukimin e tij.

Gjergj Kastrioti u ngjiti në rangun e sanxhakbeut në moshë të re. Kur ishte 25 vjeç, i vdiq i ati që atë kohë ishte sundimtar në Krujë. Atëherë, Skënderbeu i kërkoi sulltanit postin e të atit. Mirëpo, meqë dëshironte ta sillte në pozita më të rëndësishme (ndoshta ta bënte më vonë kryevezir), sulltan Muratit II dërgoi një person tjetër në sanxhakun e Krujës.

Skënderbeu u prek shumë nga ky trajtim dhe kërkoi rrugët e shpagimit. Atë kohë, ndërsa sulltan Muratit II merrej me austriakët dhe ushtria osmane ndodhej për fushatë në Moravë, Skënderbeu ndodhej në efektivin e ushtrisë. Dhe, ndërsa bënte plane dezertimi, u muar vesh fshehtëzi me disa persona dhe përgatiti një ferman (dekret) të falsifikuar.

Më në fund, Skënderbeu u largua fshehtëzi nga ushtria dhe shkoi në Krujë. Aty, së bashku me persona të mbledhur rreth tij, mori në dorëzim kalanë e Krujës me dekretin e falsifikuar dhe vrau ushtarët që ndodheshin brenda. Pastaj organizoi marrëveshje kundër osmanëve në bashkëpunim me venedikasit, hungarezët dhe serbët.

Kryengritja e Skënderbeut që vazhdoi për një kohë të gjatë, e preokupoi shumë shtetin osman në këtë gjeografi. Veçanërisht sulltan



EPITAFI I ÇEZMËS
ME ARKITEKTURË TË ARKITEKT
SINANIT - 975 HIXHRI/1567

Mehmeti II shpenzoi shumë kohë dhe përpjekje për ta eliminuar këtë shqetësim që i preokupoi osmanët për më shumë se 25 vjet. Skënderbeu sundoi gjatë kësaj periudhe duke i vënë Krujën dhe Shkodrën nën vartësi të Venedikut. Këto vite, si në periudhën e Muratit II, ashtu edhe të Sulltan Mehmetit II, Fatihut, kaluan vazhdimisht në luftë me osmanët. Kështu, Skënderbeu shërbeu si barrierë për osmanët në Adriatik në emër të Venedikut dhe Papatit.

Më në fund, pasi luftoi për 25 vjet kundër osmanëve, Skënderbeu u detyrua ta linte luftën. Pas Shkodrës, u mor edhe Kruja nga vetë sulltan Fatihu. Fatihu i mori vetë në dorëzim çelësat e Krujës (883 h /1478). Skënderbeu u tërhoq në Lezhë për të bërë një jetë të izoluar gjer në vdekje (1468).

MYFTIU I SHKODRËS: “DËNOJMË TERRORIZMIN DHE KOMPLOTIN KUNDËR TURQISË!”

Nga minberi i xhamisë së Tophanës, të xhumanë më 19 shkurt 2016, Myftiu i Shkodrës Imam Muhamed B. Sytari, ka dënuar aktet terroriste të para dy ditëve në kryeqytetin e Turqisë Ankara.

Myftiu tha se sinjalet e shpërthimeve të Ankarasë janë shenjë e tërbimit të terroristëve të vërtetë, të cilët ka mbi një shekull që punojnë pa ndërprerje kundër Islamit dhe muslimanëve në mbarë botën.

“E dënojmë komplotin e forcave të së keqes kundër Turqisë dhe muslimanëve në përgjithësi, sidomos në këto kohë, kur rizgjimi i muslimanëve ka nisur dhe duhet të jemi të gatshëm të presim të papritura të ndryshme nga taborrat e iblisëve që punuan kundër kalifatit tonë osman e, sot punojnë kundër rizgjimit islam në mbarë botën!” - tha Myftiu.

Njëkohësisht theksoi se rizgjimi i



ymetit islam ka nisur dhe se nuk ka forcë në botë që e ndalon bahkimin dhe forcimin e muslimanëve, për t'u rikthyer si pushtet ndërtues dhe forcë paqeje për mbarë botën, që sot lëngon shkatërrimin, degradimin, korrupsionin e mashtrimin e sistemeve të dështuara globale.

Myftiu kërkoi që të gjithë të

luten për viktimat e terrorizmit antiislam e antinjerëzor në Turqi, si dhe të punojnë me të gjitha forcat për shtimin e harmonisë dhe bashkëpunimit në mes vete, për të rikthyer në praktikë domethënien e vërtetë të vëllazërisë së shenjtë islam dhe bashkëpunimin real të muslimanëve në mes vete!



Dy nipër të Skënderbeut u kthyen në Stamboll në kohën e sulltan Sulejmanit të Madhërishëm, u bashkuan me osmanët dhe u bënë myslimanë. Njëri prej tyre mori emrin Skënderbej dhe u ngjit gjer në detyrën e kryeargjendarit. Kryeargjendari Skënderbej ndërtoi një shkollë fillore afër xhamisë dhe medresesë së Zall Mahmud Pashës në Ejup dhe një çezmë që ndodhet poshtë xhamisë Ajvansaraj Koruxhu Mehmet Çelebi në breg të haliçit. Epitafi i çezmës me arkitekturë të Arkitekt Sinanit, i zhdukur në vitin 2004, kishte datën 975 hixhri/1567, si më poshtë:

Një bamirësie të çuditshme i hyri kryeargjendari Skenderbej:

Derdhi argjend e flori, ngriti në këmbë lotuesin si çezmë;

Ndërtesë iu bë prita Skender, uji

iu bë eliksir

Si hizri, jetë të pasosur gjeti kur e bëri pije atë

Plotësimi i gëzimit të vulës me përpjekjen, e thashë

Datën; e kish gjetur Skenderi ujin e gjëllesës së njëjtë.

Vdekur më 990 hixhri/1582, Skënderbeu është varrosur në rrethinat e Ejup Sulltanit.

Kurse në vend të shkollës së shembur nga vajza e Mustafait III, Shah Sulltan, janë ndërtuar gjithashtu prej saj Shkolla Shah Sulltan dhe Çezma Publike, që ekzistojnë edhe sot. Kurse epitafi i çezmës poshtë xhamisë Ajvansaraj/Koruxhu Mehmed Çelebi, e cila nuk ekziston sot, është grabitur dhe ndodhet në gjendje rrënoje. Skenderbej (i riu), ngaqë kishte

krushqi me familjen e Dukagjinasve, në disa burime bibliografike, si Gjenealogjia Osmane, është shënuar gabimisht edhe si Dugacinzâde (princ Dukagjinas).

Pas eliminimit të kryengritjes së Skënderbeut, tokat shqiptare hynë plotësisht nën administrimin osman. Dy vëllezër nga princat Dukagjinas, që sundonin në Prizren dhe përreth, erdhën në Stamboll në periudhën e sulltan Fatihut dhe morën emrat Ahmed dhe Mahmud. Nga këta, Mahmudi vdiq në moshë të re, kurse Ahmedi shërbeu si vezir dhe vali. Një varrezë familjare e Dukagjinasve ekziston akoma në Ejup ngjitur me Shkollën Shah Sulltan dhe Çezmën Publike (sebil).

(www.dritaislame.al)



Idmir Plaku
imam, xhamia "Ebu Bekër"

Hyrja në xhenet është qëllimi parësor që besimtarët synojnë të fitojnë përmes ibadetit dhe veprave të mira. Rrugët e hyrjes në xhenet janë treguar nga Pejgamberi (a.s) dhe ato përshkruhen nga përkushtimi dhe sakrifica.

Allahu (xh.sh) besimtarëve u ka bërë ofertë mallin më të muar, xhenetin, për ta fituar me ibadetin e tyre. Pejgamberi (a.s) e ka vijëzuar rrugën e hyrjes dhe të fitimit të kësaj oferte të muar, e shtëpie të përhershme në jetën e amshueshme. Fillimin e kësaj rruge, Pejgamberi (a.s) e tregon duke thënë: "Kush i frikësohet (beson) Allahut (xh.sh) e ka gjetur rrugën, kush e ka gjetur rrugën arrin në shtëpi, e në të vërtetë malli i Allahut ka mim të lartë, vërtetë që malli i Tij është xheneti!"¹

Falja e namazit të sabahut është një mirësi e madhe për besimtarët, sepse e fillon ditën tënde duke ecur në një rrugë që të on drejt xhenetit. Udhëzimi vjen nga Allahu (xh.sh): "Lexo Kur'an në agim. Me të vërtetë, që falja e mëngjesit është e dëshmuar (nga melaiket)."² Të falësh namazin e sabahut me xhemat ke hyrë në grupin e atyre që i përmendin melaiket tek Allahu (xh.sh) për besimin e tyre. Në këtë kontekst, Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Ndërrohen tek ju melaiket natën me melaiket ditën, grumbullohen të gjithë në faljen e sabahut dhe të iqindisë, ngrihen në qiell ata që ishin tek ju dhe i pyet Zoti i tyre: "Si i latë robërit e Mi (e Ai e di për ata)? I thonë: I gjetëm duke u falur, u larguam dhe ata vazhduan të faleshin."³

Namazi i sabahut ka një vend të veçantë dhe shpërblim të madh tek Allahu (xh.sh). Faljen e këtij namazi Allahu (xh.sh) e veçoi në kujtesë nga

MIRËSIA E FALJES SË NAMAZIT TË SABAHUT

"Kush e fal namazin e sabahut është në besë të Allahut."

namazet e tjera. Ky është namazi që në të marrin pjesë melaiket e ditës dhe ato të natës. Ky është namazi që falja e tij me xhemat ka vlerën e faljes namaz gjithë natën. Uthman ibn Affani (r.a) tregon se Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kush ka falur namazin e jacisë me xhemat i shkruhet atij falja e gjysmës së natës, e kush fali sabahun me xhemat i shkruhet atij sikur është falur gjithë natën."⁴

Falja e namazit të sabahut ka një frymë shpirtërore të veçantë, që jo kushdo e posedon. Kush dëshiron që ta fillojë ditën në besën e Allahut (xh.sh) duhet ta falë namazin e sabahut. Në lidhje me këtë Pejgamberi (a.s) thotë: "Kush e fal namazin e sabahut është në besë të Allahut."⁵ Është veuar namazi i sabahut, sepse në të ka sakrificë, përkushtim, ndjenjë përgjegjësie. Nuk e fal atë, përveç ai që ka besim të singertë, të tillët padyshim që janë në mbrojtjen e Allahut.⁶ Andaj kushtoj vëmendje namazeve, e në veanti namazit të sabahut, identifikoj veten tënde me të dhe jo me gjumin në këtë kohë të bereqetshme. Ky është namazi në të cilin burrat peshojnë besimin e tyre. Ky namaz për sahabet (r.a) ka qenë peshore besimi, në të cilën peshonin burrat. Kush merrte pjesë në të, krijonin mendim të mirë për të, e nëse mungonte krijohej mendim i keq. Ibën Mes'udi (r.a) ka thënë: "Vertetë që në këtë namaz jemi peshuar, askush nuk mungonte në të, përveçse hipokriti i njohur për hipokrizinë e tij." Ndërsa Ibn Umeri (r.a) ka thënë: "Kemi qenë, që nëse mungonte ndonjëri prej nesh në faljen e namazit të sabahut krijonim mendim të keq për të."

Kur lexon, dëgjon apo shkruan për këta besimtarë, burra të besimit, vetvetiu parashtrohet pyetja se, a ka burra të namazit të sabahut që peshojnë besimin e tyre në të? Nga rëndon më shumë peshorja në këtë kohë të bereqetshme, nga gjumi apo namazi? Pse besimtari, me gjumin e tij në këtë kohë, bëhet pengesë për marrjen e rrizkut, që ka caktuar Allahu (xh.sh)? Këto pyetje e të tjera si këto duhet t'i

parashtrijë vetes besimtari në ditët e sotme.

Padyshim, që rrizku dhe bereqeti është për atë që fal namazin e sabahut me xhemat, sepse kjo është koha e begatisë në rrizk. Në këtë kontekst Pejgamberi (a.s) ka thënë: "O Allah! Begatoje ymetin Tim në zgjimin herët."⁷ Kjo është koha e sabahut por mund t'i thuash edhe e rrizkut.

Ibn Abasi (r.a) një herë e gjeti djalnin e tij fjetur në sabah, pastaj i tha: "Biri im zgjohu, a dëshiron të flesh gjumë në orën në të cilën ndahet rrizku?" Prandaj përjetoni këtë namaz në kohën e bereqetshme të tij, sepse mirësitë e Allahut (xh.sh) janë të shumta. Kërkoje rrizkun e Allahut (xh.sh) duke filluar që me faljen e namazit të sabahut se ndihmën e bereqetin do ta kesh pranë përherë.

Vëllai im besimtar, lexues i nderuar!

I shkrova këto fjali për mirësitë e mëdha të faljes së namazit të sabahut me xhemat i nxitur nga numri i pakët i besimtarëve që marrin pjesë në të, megjithëse mirësitë e kësaj kohe dhe këtij namazi janë të mëdha. Ky namaz është tërheqës për besimtarë të singertë dhe i rëndë për hipokritë. Ky namaz është ai që i bën për vete burrat e besimit, të cilët sakrifikojnë për të marrë mirësitë e tij. Janë këta besimtarë që e kanë kuptuar më së miri vlerën e kësaj kohe dhe thënien e Pejgamberit (a.s) që thotë: "Nëse do ta dinin mirësinë, se çfarë ka në faljen e jacisë dhe të sabahut do të vinin në to, qoftë edhe duke u zvarritur."⁸ Prandaj garoni për të qenë të përhershëm në faljen e namazit me xhemat që të merrni mirësitë e Allahut në këtë kohë të bereqetshme. Gjallëroni namazin e sabahut me xhemat në xhami dhe mos i nënvleftësoni këto mirësi. Faleni këtë namaz në kohën e vet që të jeni në mesin e besimtarëve, për të cilët kanë dëshmuar melekët. Rehatia e qetësia e besimtarit në kohën e sabahut është duke u falur dhe jo duke fjetur. Koha e sabahut është koha e mëshirës, qetësisë, ndarjes së rrizkut dhe e dëshmisë së melekëve për ty.

1. Muttefekun alejhi.

2. Kur'ani, El-Isra: 78.

3. Muttefekun alejhi.

4. Transmetuar nga Muslimi dhe Ahmedi.

5. Transmetuar nga Muslimi.

6. "Fejdul-Kadir", i Menavit 6/213.

7. Transmetuar nga Tirmidhiu dhe Ebu Davudi.

8. Muttefekun alejhi.

MYFTIU: “FEJA, JETA, MENDJA, TRASHËGIMIA DHE PASURIA NUK PREKEN!”



Ditën e xhuma, më 29 janar 2016, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një vizitë në shtëpinë e familjes Shkambi, në Drisht, për të ngushëlluar familjarët e dy vëllezërve, Abdullah e Skënder Shkambi, që u vranë para disa ditësh nga një bashkëfshatar i tyre.

Qëllimi i kësaj vizite ishte edhe shprehja e mirënjohjes së Myftinisë Shkodër për krejt fisin Shkambi dhe burrat e tij të urtë, që vendosen lirim e familjarëve të vrasësit nga gjakmarrja.

Myftiu tha se përtej dhimbjes, shembulli i kësaj familjeje dhe fisi të nderuar në Drisht, e tejkalon këtë moment sprove dhe kthehet në një vlerë humanizmi, besimi dhe qytetarie të lartë.

Edhe në hytben e tij të xhumasë, Imam Muhamed B. Sytari, vlerësoi shembullin e këtij fisi dhe u lut për paqtimin e njerëzve dhe kthimin e tyre nga besimi dhe Islami.

“Mirësia e madhe dhe bujaria e shpirtit, e dëshmuar botërisht nga fisi Shkambi, në fshatin tuaj, me rastin e fatkeqësisë së papritur që goditi familjet e tyre, u bë shkak obligues për mua që të jem sot në Drisht, duke u lutur e falur bashkarisht në këtë ditë të begatë të xhumasë.

Lajmi i bërë publik, që burrat e këtij fisi me emër, liruan nga gjakmarrja familjarët dhe fisin e personit që

preku në shpirtin e tyre, jo vetëm që më mbushi me emocion të madh besimi dhe shprese, por u kthye në një detyrim moral, besimor e qytetar, për të ardhur sot në xhaminë tuaj dhe nga ky minber i të dërguarit të All-llahut, botërisht t’u them: All-llahu jua zbardhtë faqen në këtë botë dhe në ahiret, o burra të urtë e besimtarë të fisit Shkambi!

Drishti dhe Postriba, janë një kala e fortë e besimit dhe e Islamit, ku njerëzit e mirë të kësaj toke, historikisht kanë dëshmuar vlera të larta të besimit, harmonisë, paqes, punës së ndershme, fitimit të hallallit, nderit të grave e burrnisë tipike të burrave të urtë e largpamës të kësaj zone!

Ne si muslimanë, e kemi për detyrë dhe obligim fetar të jemi përherë afër njëri-tjetrit, në gëzime e në hidhërime, në dëshpërime e në sihariqe, me të cilat sprovohet jeta e jonë.

Sot, më shumë se kurrë, ne si muslimanë, si shqiptarë, si vëllezër të një besimi, një gjaku e një gjuhe, e kemi për detyrë të mbjellim farën e bekuar të pastrimit të zemrave nga inatet, smira, urrejtja e pusitë kundër njëri-tjetrit! E kemi për obligim fetar e kombëtar ta ruajmë të paprekur shenjtërinë e jetës, familjes, farestit, atë të komshiut të mirë e mikut-vëlla, për të cilët na porosit Kur’ani dhe Hz. Muhammedi (a.s) në ajete dhe hadithe të shumta!” - tha Myftiu.



**“KUR SHIKON
KASAPIN DUKE
DHËNË FETVA,
MOS PRIT
ASGJË TJETËR
PREJ TIJ,
VETËM SE
DUKE KËRKUAR
PËR NDONJË
KURBAN!”**

Shejkh Muhamed El-Gazali
(1917-1996)



AKTIVITETE GJATË MUAJT



E TË BEGATA IT SHKURT...



Mbrëmjen e së xhumasë, më 29 janar 2016, në kuadër të projektit të derseve të akshamit, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mbajti një ligjëratë në xhaminë e re të lagjes Dudas.

Në qendër të fjalës së tij ishte tematika e shpresës në mëshirën e All-llahut dhe frika nga ndikimi i gjynaheve në jetën e përditshme dhe në jetën e përtejme.

Myftiu shpjegoi se kur themi: “frika e Zotit”, nënkuptojmë kulmin e dashurisë dhe lidhjes së njeriut besimtar me Zotin e tij, i cili e ruan veten që mos ta shohë Zoti, aty ku ia ka ndaluar të jetë. Të mos e dëgjojë të flasë, atë që ia ka ndaluar ta thojë në komunikimin e tij me të tjerët. Të mos e shohë duke vepruar ndalesat a duke mosvepruar urdhëresat, që Zoti i ka sqaruar në dobi të njeriut dhe mbarëvajtjes së jetës së tij në tokë.

Gjatë dërsit të kësaj nate, Myftiu iu referua disa haditheve, nëpërmjet

DERSI I AKSHAMIT: “SHPRESA NË ZOTIN DHE FRIKA E GJYNAHEVE”



të cilave shpjegoi se Zoti i gjithësisë e ka ftuar njeriun të mendojë mirë për Madhërinë e Tij, si dhe të shpresojë në mëshirën dhe faljen e Tij.

Pas ligjëratës, u zhvillua edhe

një bashkëbisedim vëllazëror rreth problematikave të mirëfunksionimit të xhamisë, rregullores së saj, përkujdesjes për më të mirën e xhamisë etj.

MYFTIU PRITI DREJTORIN E SHOQATËS “SULEJMANIJE”, Z. NUSRET TEKIN

Paraditën e të enjtes, më 4 shkurt 2016, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt dhe vëllazëror z. Nusret Tekin, drejtor i Shoqatës “Sulejmanije” për Shqipërinë.

Gjatë takimit, Myftiu vlerësoi kontributin e madh që shoqata “Sulejmanije” ka dhënë në dy dekadat e fundit në Shkodër e në shumë qytete të Shqipërisë, në kuadër të edukimit të brezit të ri me dashurinë për Kur’anin, mësimin dhe hivzin e tij.

Myftiu theksoi se shërbimet ndaj Kur’anit, nëpërmjet hapjes së kurseve të shumta, qendrave edukative dhe arsimore në këtë drejtim, janë shërbimi më i mirë që i bëhet Thirrjes Islame dhe mbjelljes së dashurisë për Fjalën e Zotit dhe



mësimin e Kur’anit në zemrat e rinisë shqiptare.

Nga ana e tij, z. Nusret Tekin falënderoi Myftininë e Shkodrës për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe shprehu gatishmërinë e shoqatës së tij për të kontribuar në drejtim të

hapjes së kurseve të reja të Kur’anit, si dhe mësimin e tij në xhami të ndryshme nëpërmjet mësimin të tij.

Ai konfirmoi edhe një herë qëllimet e kësaj shoqate në drejtim të përhapjes së kurseve për mësimin e Kur’anit Famëlartë.

Ditën e enjte, më 4 shkurt 2016, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim pune, koordinаторin e Dijanetit të Turqisë në vendin tonë, z. Yasin Şengül, me të cilin diskutoi rrugët e bashkëpunimit.

Gjatë këtij takimi, Myftiu theksoi se propaganda komuniste dhe e armiqve të ndryshëm të Islamit në vendin tonë, kanë kontribuar maksimalisht që të krijojnë hendeqe paradoksale në marrëdhëniet në mesin e vendit tonë dhe Turqisë.

Myftiu tha se kalifati osman është pjesë e lavdisë shekullore islame dhe se shqiptarët dhe turqit kanë bashkëpunuar së bashku për shekuj të tërë.

Njëkohësisht, Myftiu falënderoi kontributet e vazhdueshme të Dijanetit të Turqisë në vendin tonë, për të cilat tha se ato duhet të jenë më intensive në shërbim të interesave të Thirrjes Islame në Shqipëri.

Myftiu tha se dita-ditës Dijaneti i Turqisë po kthehet në një institucion islam me kontribute të vjera dhe konkrete edhe përtej kufijve të

MYFTIU PRITI KOORDINATORIN E DIJANETIT TË TURQISË, Z. YASIN ŞENGÜL



Republikës së Turqisë.

Nga ana e tij, z. Şengül theksoi se Dijaneti është i interesuar të bashkëpunojë me faktorët islamë në mbarë botën, sikurse edhe në Shqipëri,

në shërbim të interesave të përbashkëta në të mirë të Thirrjes Islame.

Për rreth një orë, dy bashkëbiseduesit diskutuan rreth rrugëve të bashkëpunimit dhe forcimit të tij.

CEREMONIA E GURTHEMELIT TË XHAMISË SË RE NË BUSHAT

Ditën e xhuma, më 5 shkurt 2016, pas faljes së namazit të xhumasë në xhaminë e Bushatit, Myftinia Shkodër dhe Fondacioni “Mirësia” organizuan ceremoninë e gurthemelit për xhaminë e re në vakëfin e xhamisë së vjetër në Krye Bushat.

I pranishëm në këtë ceremoni ishte Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, Drejtori i Fondacionit “Mirësia”, z. Korab Kaja, Drejtori i Shoqatës “Sulejmanije” për Shqipërinë, z. Nusret Tekin, imamë të xhamive të ndryshme dhe besimtarë të zonës.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Myftiu i Shkodrës, vlerësoi këtë ditë si një moment të gëzueshëm dhe historik për Bushatin, Shkodrën dhe krejt muslimanët e vendit, sepse xhamia e re është dëshmi besimi dhe udhëzimi islam për këtë zonë.

Myftiu falënderoi kontributin e Fondacionit “Mirësia” për sigurimin e fondit për mundësimin e realizimit të projektit bashkëkohor për xhaminë e re.

Ceremoninë e përshëndeti edhe z. Korab Kaja, që uroi të pranishmit për



këtë ngjarje të shënuar për komunitetin musliman të Bushatit dhe Myftininë Shkodër. Ai theksoi se ky projekt vjen si pjesë e bashkëpunimit me “Zekat House” në Kuvajt dhe me mbarësinë e All-llahut, shumë shpejt, të gjithë do ta gëzojmë xhaminë e re.

Edhe kryeplaku i zonës, z. Zyhdi Mustafa, shprehu falënderimet e tij dhe mirënjohjen për Myftininë Shkodër dhe Fondacionin “Mirësia”, sikurse vlerësoi

bashkëpunimin dhe interesimin e madh të besimtarëve të kësaj zone për arritjen e kësaj dite të gëzuar.

Me tekbiere e salavate, u zhvillua edhe ceremonia simbolike e gurthemelit të xhamisë së re, që pritet të realizohet në harkun e një viti.

Në fund, Hafiz Shukri Kapllan bëri një lutje për mbarësinë e punimeve dhe suksesin e tyre.

U ZHVILLUA KONFERENCA E V-TË E IMAMËVE TË MYFTINISË SHKODËR



Paraditën e së shtunës, më 6 shkurt 2016, u zhvillua konferenca e V-të e përvitshme e imamëve, teologëve, thirrësve islamë, muezinëve dhe këshilltarëve të Myftinisë Shkodër.

Konferenca në fjalë, ka për qëllim të nxjerrë në pah boshtin vjetor të aktivitetit dhe thirrjes së imamëve dhe thirrësve islamë të Myftinisë Shkodër.

Fillimisht, konferenca u përshëndet nga Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari, i cili iu drejtua të pranishëmve me një këshillë të dijetarit të shquar Shejkh Shaaravi: “Thirrësi islam duhet të ruhet, të mos e shohë i ftuari duke bërë të kundërtën e asaj që flet, sepse të gjithë sytë sillen përreth tij, krejt prozhektorët janë të përqendruar drejt tij! Thirrësi duhet të ketë kujdes, mos të dëgjojnë prej tij nxënësit e tij ndonjë fjalë që bie ndesh me veprën e tij!

Misioni i thirrësit sot, është i vështirë, shumë i vështirë...sepse ai thërret drejt All-llahut, në një botë, ku janë shtuar ngjyrat e diversitetit të kulturës së tij, sikurse ngjyrat e ndikimit të saj në mendje... Prandaj, ai duhet të ketë njohuri rreth krejt ngjyrave të kulturës, të posedojë aftësitë e ndikimit ndaj atyre që i fton në Islam! Sepse, nëse ai nuk do të ketë lidhje me kulturën e kohës së tij, do të zvogëlohet në sytë e atyre që fton! Thirrësi duhet ta zotërojë lidhjen e tij me All-llahun, nëpërmjet disiplinimit të plotë me urdhëresat e All-llahut dhe traditës së profetit të Tij; sepse baterinë, prej së cilës pret furnizimin me dritë, duhet ta karikosh në mënyrë sistematike!”

Konferenca vazhdoi me përshëndetjen e nënkryetarit të KMSH, H. Bujar Spahiu, i cili u përqendrua te domosdoshmëria

e përhapjes së vlerave të fesë islame me urtësi dhe dije, në realitetet e sotme shqiptare. Ai tha se përpjekjet e dikujt për ta shfrytëzuar Islamin për nxjerrjen në pah të egos së tij, ndikon negativisht në impaktin e fesë në shoqëri.

H. Bujar Spahiu vlerësoi angazhimin e imamëve dhe thirrësve islamë në lartësimin e mesazheve të harmonisë dhe mirëkuptimit në mesin e muslimanëve, si dhe përhapjen e paqes sociale, nëpërmjet shërbimeve të shumta fetare.

Më pas, konferenca vijoi me referatet e përgatitura nga teologët dhe imamët e nderuar, sipas programit:

- Teologu Artur Tagani: “Prapaskena historike e qëndrimit negativ ndaj Muhammedit (a.s)”.

- Thirrësi islam Lavdrim Hamja: “E vërteta e xhiadit në Islam”.

- Teologu Durim Kasemi: “Të krishterët në mëshirën e drejtësisë dhe tolerancës islame”.


- Teologët Arben Halluni dhe Admir Temja: “Koncepti i lirisë në Islam”.

- Teologu Naim Drijaj: “Mëshira e Muhammedit (a.s) për krijesat e Zotit”.

(Për arsye shëndetësore mungoi referati i teologut Ervil Kuçi: “Tefsiri i ajetit: Err-Rrahman Err-Rahim”)

Të pranishëm në këtë konferencë ishin edhe kryevaizi i KMSH, H. Lauren Luli, Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, drejtori i Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, z. Kujtim Dervishi, drejtori i Shoqatës “Burimi”, z. Sokol Mandi, intelektualë, përfaqësues të shoqatave islame, studentë të teologjisë etj.

Materialet e konferencës së V-të, do të botohen të plota në një botim të veçantë të Myftinisë Shkodër.



*Për të shkatërruar
një popull,
nuk ka nevojë
për bombë atomike,
apo raketa
me rreze të gjatë
veprimi, mjafton
të ulësh
cilësinë e arsimit.*

MYFTIU I SHKODRËS: “ISLAMI DHE TERRORIZMI I KANË RRUGËT E NDARA!”



Mbrëmjen e së enjtes, më 11 shkurt 2016, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ishte i ftuar i gazetarit Simon Shkreli, në emisionin e tij “Hapur”, në TV1 Channel.

Gjatë bashkëbisedimit, Myftiu iu përgjigj pyetjeve të ndryshme, që kanë të bëjnë me realitetet e Myftinisë Shkodër dhe aktivitetin e saj gjatë vitit jubilar 2015 e në vazhdim, përballjes së muslimanëve me islamofobinë dhe ngjarjet e viteve të fundit në vendet e Lindjes, terrorizmi dhe etiketimi i padrejtë i Islamit dhe muslimanëve me nofkat e tij, laiciteti i shtetit shqiptar dhe kërkesa për futjen e lëndës së edukimit fetar në shkollat e vendit etj.

Nëpërmjet këtij bashkëbisedimi, Myftiu konfirmoi edhe një herë vullnetin e Myftinisë Shkodër për të punuar maksimalisht në rrugën e lartësimit të vlerave shekullore të Thirrjes Islame, përhapjen e Fjalës së All-llahut dhe mësimet të Hz. Muhammedit (a.s), të dërguarit mëshirë për mbarë botrat.

Duke folur mbi terrorizmin dhe fatkeqësitë e mëdha që po trazojnë qetësinë e botës sot, Myftiu tha se Islami nuk ka asnjë lidhje me shfaqjet terroriste të grupimeve të shumta, në thelbin e të cilave qëndron frikësimi dhe terrorizimi i njerëzve, aq më shumë sot, kur argumentet

po vërtetojnë lidhjen e shërbimeve antiislame të vendeve të ndryshme me krijimin e këtyre grupeve të së keqes. Myftiu tha se Islami dhe terrorizmi janë dy gjëra të ndryshme, i kanë rrugët e ndara!

Myftiu tha se shembulli më i mirë i asaj që realisht fton drejt saj feja islame, është qëndrimi i profetit Muhammed (a.s) me robët e luftës, ditën kur hyri në Mekë triumfues; falja dhe lirimi!

Ai tha se Evropa e di mirë shembullin e muslimanëve, drita e qytetërimit e të cilëve u bë shkak për përhapjen e dijes dhe largimin e reve të zeza të injorancës dhe analfabetizmit prej saj, sidomos në kohën e kalifatit në Andaluzi. Ai tha se pas rënies së kalifatit në Spanjë, hebrenjtë u strehuan dhe jetuan në liri në zemër të kalifatit osman, ndërsa muslimanët u sharruan dhe u dogjën për së gjalli në shfaqjet më të llahtarshme të terrorit; inkuizicionit famëkeq!

Myftiu bëri thirrje që drejtuesit e komuniteteve fetare duhet të bashkëpunojnë, që lënda e besimit dhe edukatës fetare të jetë pjesë e kurrikulave të arsimit shqiptar, njëlloj si në shumë vende të Evropës sot, njësoj si shumë dekada më parë, kur në Shqipëri kjo lëndë u mësohej fëmijëve shqiptarë.



**"ËSHTË DOMOSDOSHMËRI
E BOTËS MBARË,
NJË RIGJALLËRIM FETAR,
QË LARTËSON FLAMURIN
E TË VËRTETËS NË MESIN
E TË GJITHË FLAMUJVE
TË HUMBUR QË EKZISTOJNË
DHE NEVOJË BOTËRORE.
SEPSE, DEFICITI
(PAMJAFTUESHMËRIA) BOTËRORE,
SËMUNDJET GLOBALE
DHE MUNGESA E FRIKSHME
E TURPIT, DËSHMOJNË
NË ÇDO VEND SINQERITETIN
E KËTIJ MISHËRIMI..
DHE, PËR T'IA ARRITUR
KËTIJ QËLLIMI, PATJETËR DUHET
NJË RISHIKIM I PARAQITJES
SË FESË NË RRËNJËT E SAJ
TË PASTRA DHE ME NJË GJUHË
BOTËRORE BASHKËKOHORE,
QË I DREJTOHET TË GJITHËVE
NË ÇDO VEND, E JO ME NJË GJUHË
SEKTARE TË VETËMBYLLUR".**

Dr. Mustafa Mahmud

Paraditën e së shtunës, më 13 shkurt 2016, Myftinia Shkodër organizoi një aktivitet përkujtimor në nder të imamit Hafiz Halim Hajdari (1891-1965).

Aktiviteti, që u zhvillua në bibliotekën e qytetit, nisi me fjalën e hapjes, në të cilën thirrësi islam Lavdrim Hamja, bëri një vlerësim të imamëve dhe hoxhallarëve të shquar të Shkodrës, të cilët punuan me shumë përkushtim në rrugën e mësimi të popullit dhe edukimin e tij me vlerat islame dhe ato kombëtare.

Imami i nderuar theksoi se hafizët e Kur'anit janë njerëz të përzgjedhur nga All-llahu dhe të dashuriut e tij.

AKTIVITET PËRKUJTIMOR PËR IMAMIN HAFIZ HALIM HAJDARI

Ai vlerësoi kontributin e Hafiz Halim Hajdarit, si një imam dhe prijës islam, që punoi me shumë se një gjysëm shekulli në shërbim të Islamit dhe shoqërisë.

Në referatin e tij me temë: “Në kujtim të Hafiz Halim Hajdarit (1891-1965), në 125 vjetorin e lindjes...”, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, solli para të pranishëmve vlerësimet që kanë bërë studiues e hulumtues të ndryshëm për Hafiz Halim Hajdarin, duke theksuar se ai i përket zinxhirit

të hoxhallarëve që kanë marrë ixhazete nga hoxhallarët e shquar të Shkodrës, si: Hafiz Halid Bushati dhe nxënësi i tij Hafiz Jusuf Këlmendi.

Më pas, hulumtuesi Smajl Bala, mbajti një referat me temë: “Jeta dhe vepra e Hafiz Halim Hajdarit në arkivat e kohës”, ku hodhi dritë mbi gjurmët e këtij imami të nderuar që ka shërbyer për shumë dekada në xhami të ndryshme të Shkodrës, si në: Rrjoll, Tophanë, Parrucë, Rus, Pazar, në xhaminë e Plumbit etj.

MYFTIU, TAKIM ME TË RINJ MUSLIMANË: “EKSTREMIZMI BURON NGA KEQLEXIMI I FESË!”



Ditën e mërkurë, më 17 shkurt 2016, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ka marrë pjesë në një takim të organizuar nga Shoqata “Ardhmëria”, dega Shkodër, me të rinj muslimanë të qytetit tonë.

Në thelb të takimit me të rinjtë ka qenë tema e mesatarizmit dhe ekstremizmit në kuptimin dhe praktikimin e fesë dhe modeli i muslimanit në shoqërinë shqiptare.

Gjatë ligjëratisë së tij, Myftiu ka folur mbi rëndësinë që ka leximi i ekuilibruar i fesë dhe teksteve të saj, si dhe ruajtja nga interpretimi individual dhe egoistik i teksteve të shenjta, që shpie në devijim ekstrem nga thelbi i fesë.

Myftiu tha se: “në këto 25 vite të fundit, ka plot shembuj dhe raste, kur individë a grupe shoqërore, kanë

devijuar tekstet tona fetare, kanë keqinterpretuar e keqprezantuar fenë dhe tekstet e saj, duke krijuar stereotipe me nuancë fetare në realitetet tona. Unë mendoj se mungesa e edukatorëve të mirëfilltë islamë dhe leximet e paekuilibruara të fesë, shkaktojnë sjellje ekstreme në raport me leximin dhe më pas praktikimin e fesë në jetë.”

Gjithashtu tha se: “Tema e ekstremizmit a mesatarizmit, si dy koncepte diametralisht të kundërta me njëra-tjetrën, lidhet në zanafillën e saj me sjelljen dhe prirjen morale e shpirtërore të secilit. Dmth, një individ i edukuar, i ruajtur, i kulturuar, është e vështirë të devijojë në ekstremin e keqpërdorimit të teksteve fetare. Këtë e vërteton edhe realiteti i shumë të rinjve të pashkolluar e të paformuar intelektualisht, që duke u lidhur pas

një boshti të caktuar argumentesh dhe faktesh të keqlexuara fetare, nisin dhe e dëshmojnë fenë në aparenca dhe lëvizje, që i bëjnë të dallueshëm nga të tjerët. Të mbyllur, të ngurtë, të ngrysur, të gatshëm për të kundërshtuar, të pamundshëm për të toleruar, të nxituar, me pak fjalë, ekstremisht të paformuar!”

Në fund, Myftiu tha: “Dua ta mbyll me shënimet e studiuesit islam të afirmuar, Dr. Salahuddin Keftaro, kur thotë: [Sa shumë e dëmtojnë fenë disa praktikantë të fesë!? Ndonjëri prej tyre ndjek me korrektësi faljen e namazeve me xhemat në xhami, por ai është i pasjellshëm me gruan dhe fëmijët e tij! Ndonjëri prej tyre mburret me gjatësinë e mjekrës që mban, por mashtron në shitblerjen e tij! Shohim një të mbuluar, që ndjek me përpikmëri ligjëratat e ndryshme javore, por është e paedukatë me nënën e saj! Shohim një ndjekës të takimeve periodike të edukimit dhe udhëzimit fetar, por që shquhet për thashetheme dhe ndezjen e ngatërresave në mesin e njerëzve! A është kjo feja? Jo, vëllezërit e mi! Origjina e dërgesës së profetit të nderuar dhe qëllimi i saj përmbledhet në thënien e tij (a.s): “Jam dërguar të plotësoj mirësjelljen!”]

Stereotipet e ekstremizmit fetar, si në hadithin me të cilin e nisa këtë ligjëratë, duhet të trajtohen me kujdes, ndërkohë, të gjithë ne jemi të ftuar ta jetojmë fenë tonë në normalitetin e kuptimit të saj, larg euforisë dhe ndjenjës së madhështisë individuale mbi të tjerët!”

NË KUJTIM TË HAFIZ HALIM HAJDARIT (1891-1965), NË 125 VJETORIN E LINDJES...

Në mars të vitit 1993, nëpërmjet gazetës “Drita Islame”, botim i Bashkësisë Islame të Shqipërisë – Komuniteti Musliman – Tiranë, u botua një artikull me titull: “Hafiz Halim Hajdari klerik aktiv e i dashur me popullin”.

Autori, teksa përpiquej të dritësonte portretin e imanit të nderuar, ndër të tjera shkruante: “Si imam dhe vaiz, ai fitoi një popullaritet të madh. Gjatë predikimit të tij fliste me një guxim të pashembullt duke goditur qëndrimin e të gjithë atyre që u binin ndesh sjelljeve njerëzore në shoqëri. Fjalët e tij të urta dhe shpirti i tij i guximshëm për t’i shërbye fesë edhe në zgjidhjen e shumë problemeve shoqërore spikasin në personalitetin e Hafiz Halimit. Fjala e tij kishte aq ndikim në popull sa që u bë bar shërues për shumë mosmarrëveshje që zakonisht lindin gjatë jetës së përditshme në njerëz... madje thirrej për ndërmjetësime të rastit... Jo vetëm kishte një ndikim në masë, por bënte pajtime edhe brenda familjes...”¹

Realisht, shoqëria e jonë shqiptare ka përherë e më shumë nevojë për shembullin e imamëve dhe hoxhallarëve të urtë pajtimtarë, përhapës të vlerave të harmonisë në familje e në shoqëri, si dhe të burrave largpamës, që bëhen ura komunikimi dhe që mbjellin mirësi nëpërmjet fjalës së urtë, si balsam shërues!

Ndërkohë, Dr. Isamil Bardhi, në monografinë e tij me titull: “Hafiz Ibrahim Dalliu dhe ekzegjeza e tij kur’anore”, teksa flet për traditën e hifzit tek shqiptarët, ndër të tjera thekson, se: “Tradita e hifzit është e njohur dhe është ndjekur me përpikëri nga besimtarët muslimanë shqiptarë që me kontaktet e para me fenë islame, ku janë krijuar edhe institucione të veçanta, komisione, dhe janë caktuar rregulla ceremoniale për këtë qëllim. Është mirë që këtu t’i përmendim disa emra të hafizëve shqiptarë të pjesës së parë të këtij shekulli, të cilët kanë luajtur rol të rëndësishëm si në aspektin teologjik, ashtu edhe në atë kulturor të kombit shqiptar: 1. Hafiz Ali Ulqinaku,

2. Hafiz Ibrahim Repishti, 3. Hafiz Adem Kazazi, 4. Hafiz Ibrahim Dalliu, 5. Hafiz Ismet Dibra, 6. Hafiz Ali Korça, 7. Hafiz Ymer Bakalli, 8. Hafiz Shefqet Boriqi, 9. Hafiz Halim Hajdari, 10. Hafiz Musa Dërguti...”²

Sipas kërkimeve të hulumtuesit Smajl Bala³, Hafiz Halim Hajdari është pjesë e zinxhirit dituror të Hafiz Halit Bushatit, Hoxhës së ditur shkodran, nga dora e të cilit dolën shumë imamë të zellshëm, të cilët lanë gjurmë në shërbimet e tyre ndaj Thirrjes Islame dhe shoqërive ku ata punuan me përkushtim të madh.

Ndërkohë, në gazetën “Drita Islame”, shkruhet se Hafiz Halim Hajdari: “kreu studimet teologjike në shkollat e kohës dhe mori diplomën nën drejtimin e Haxhi Hafiz Jusuf Këlmendit.”⁴

Përtej këtij detaji (në pamje të parë kontradiktor), që vlen të shikohet me imtësi në një studim të posaçëm mbi zinxhirët e ixhazeteve të hoxhallarëve të Shkodrës⁵, vlen të përmendet se shembulli i brezit të hoxhallarëve, imamëve dhe muezinëve të brezit të H. Halim Hajdarit, mbetet model frymëzues për imamët e kohës tonë.

Ja një detaj, shumë i rëndësishëm në këtë kontekst. Kur përmenden shërbimet e imanit të nderuar, Hafiz Halim Hajdari, mund të gjesh disa dekrete, nëpërmjet të cilëve ai caktohet të punojë si imam a edhe muezin, në disa xhami të fshatit dhe të qytetit, si: në Rrjoll, Pazar të Vjetër, Garuc, Parrucë, Tophanë, Rus etj.⁶ A nuk është kjo lëvizje, një tregues i shpirtit të përkushtimit dhe gatishmërisë për të shërbyer, pa llogaritur vendin; qyetet, fshat, xhami e madhe, xhami e vogël etj? Sepse, modeli i hoxhallarëve të brezit të Hafiz Halim Hajdarit, ishin mbi të gjitha njerëz të përkushtuar ndaj Thirrjes

2. <http://www.dielli.net/pdf/tematfetare/HavizIbrahimDalliuEkzegjeza.pdf>

3. Për më shumë të shihet: Smajl Bala, “Institucionet islame dhe hoxhallarët e Shkodrës”, Shkodër, 2005, f. 258.

4. Vib Shim, “Hafiz Halim Hajdari klerik aktiv e i dashur me popullin”, art. i cit.

5. Hafiz Jusuf Këlmendi ishte nxënës i Hafiz Halid Bushatit, ndërkohë që ishte 15 vjet më i madh në moshë se Hafiz Halim Hajdari. Nuk përjashtohet që H. Halim Hajdari të ketë marrë ixhazet nga H. Jusuf Këlmendi. (Shënim imi. M.S.)

6. Smajl Bala, vep. e cit., f. 258.

*Realisht,
shoqëria e jonë shqiptare
ka përherë e më shumë
nevojë për shembullin
e imamëve dhe hoxhallarëve
të urtë pajtimtarë, përhapës
të vlerave të harmonisë
në familje e në shoqëri,*

Islame dhe shërbimit, jo adhures pozitash, vendesh e xhematesh!?

Në përfundim, dua të lexoj para jush ajetin 10 të sures El-Hashr, ku All-llahu i Madhëruar urdhëron: [Edhe ata që erdhën pas tyre, thonë: “Zoti ynë, falna neve, edhe vëllezërit tanë që para nesh u pajisën me besim dhe mos lejo në zemrat tona farë urrejtjeje ndaj atyre që besuan. Zoti ynë Ti je i butë, mëshirues!”]⁷

Në fakt, kështu ndodhi edhe me Hafiz Halim Hajdarin, dikush u kujtua për të edhe sot, shumë dekada pasi ai nuk është më në këtë botë, në këtë 125 vjetor të përkujtimit të lindjes.

Nipi i tij, z. Bahri Hajdari, u bë shkak që sot të përkujtohet gjyshi i tij, Hoxha i nderuar, zotëria i jonë Hafiz Halim Hajdari. Me këtë respekt ndaj gjyshit të tij, nipi i nderuar na solli në mendje hadithin e pejgamberit tonë, Hz. Muhammedit (a.s), në të cilin thotë: “Kur vdes i biri i Ademit (njeriu), i ndërpriten veprat e tij, përveç tre rasteve: një sadeka e rrjedhshme, një dije prej së cilës përfiton dikush dhe një djalë i hajrit, që lutet për të!”⁸

Ky aktivitet përkujtimor në nder të një gjyshi Hoxhë, është mirësi dhe përkushtim i një nipi- “djalë hajri”, të cilin e falënderoj përzemërsisht për angazhimin dhe dëshirën e tij, që sot të jemi së bashku në këtë përkujtimore vlerash!

Imam Muhamed B. Sytari

Myfti i Zonës Shkodër

*(Fjala përshëndetëse
në aktivitetin me temë:*

*“Në kujtim të imanit
Hafiz Halim Hajdari”,*

Shkodër, më 13 shkurt 2016)

7. Kur’ani, El-Hashr: 10.

8. Transmetuar nga Imam Muslimi.

Ditën e enjte, më 18 shkurt 2016, në kuadër të “Dersit të natës së enjte”, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ligjëroi në xhaminë e fshatit Muriqan.

Pas faljes së namazit të akshamit nën drejtimin e imamet të xhamisë, Ajet Suka, Myftiu mbajti një ligjëratë, në thelbin e së cilës ishte domosdoshmëria e qëndrueshmërisë në besim dhe moslëkundja në marrëdhënie me Zotin e gjithësisë.

Myftiu tha se sprovat e përditshme me të cilat përballlet i riu musliman shqiptar, ngjajnë me flakët e xhehnemit, që duan ta përpijnë njeriun, teksa ai largohet prej tyre drejt mëshirës dhe bujarisë së Zotit të gjithësisë.

Ai tha se sprova e femohimit, e shirkut, e thirrjeve shterpë për ndërrimin e fesë, e korrupsionit, e imoralitetit, e shthurjes intelektuale, e ngushtimit të rizkut, e thashethemeve, e humbjes së kohës, e injorancës e shumë më shumë se kaq, duhen kaluar duke u mbështetur në All-llahun e Madhëruar dhe lutjen e pandërprerë drejtuar Madhnisë së Tij.

MYFTIU: “MOS NGURRONI TË KËRKONI NGA I PLOTFUQISHMI!”



“Mos ngurroni të kërkonit nga i Plotfuqishmi! Mos të bëhemi të paedukatë në hak të Zotit tonë, duke iu ankuar njëri-tjetrit; le t’i drejtohem Atij për të gjitha vështirësitë e jetës, për krejt nevojat tona, për të gjitha të

papriturat me të cilat përballemi ditë pas dite!”, tha Myftiu.

Të pranishëm në këtë tubim të begatë ishin edhe imamet e nderuar: Lulzim Beqiri, Nebi Alija, Ilir Dizdari dhe Ridvan Luzaku.

TAKIM FRYMËZUES MË NXËNËSIT E XHAMISË VELINAJ

Më datën 19 shkurt 2016, sektori i arsimit, në vazhden e takimeve me nxënësit e mejtepeve fetare dhe inspektimeve të tyre, zhvilloi një takim pune me nxënësit e xhamisë së fshatit Velinaj, Ana e Malit.

Në këtë takim, teologu Arben Halluni, foli për rëndësinë e organizmit të këtij misioni arsimor dhe kulturor, i cili ka si qëllim edukimin e brezave të rinj me frymën e besimit të vërtetë islam, me moralin e pastër të besimit dhe frymëzimin drejt vëllazërisë, harmonisë dhe mirëkuptimit në mes vete, por edhe me të gjithë njerëzit dhe pjestarët e shoqërisë.

Teologu Halluni foli dhe përcolli edhe disa këshilla fetare, që përçojnë mënyrat e të qenurit besimtar i devotshëm dhe shembull me të gjitha vlerat islame në mesin e shoqërisë



ku jeton.

Në fund të bisedës ai njoftoi për organizimin e një aktiviteti të madh (konkurs fetar) midis xhamive të Shkodrës, pjesë e të cilit do të jenë edhe nxënësit e xhamisë së fshatit

Velinaj, që mësohen me përkushtim nga mësuesi i tyre dhe imami i kësaj xhamie, z. Nebi Alija.

Në mbyllje të këtij takimi të këndshëm pati pyetje dhe përgjigje rreth temave të ndryshme.

Paraditën e së martës, më 23 shkurt 2016, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përziemërt përfaqësuesin e “Mercy International”, Kuvajt, z. Omar El-Kenderi, që shoqërohej edhe nga drejtori i Fondacionit “Mirësia”, z. Korab Kaja.

Gjatë takimit të përziemërt, Myftiu falënderoi kontributet e shumta të bamiërësve kuvajtianë, të cilët gjatë këtyre 25 viteve të fundit, kanë kontribuar dukshëm në shërbim të rimëkëmbjes së institucioneve fetare islame, objekteve të adhurimit, qendrave sociale, atyre kulturore etj.

Myftiu tha se ndihmesat e ardhura nga Shteti i Kuvajtit kanë një vlerë të madhe për muslimanët e Shqipërisë, sikurse ngelen dëshmi besimi dhe vëllazërie edhe për të ardhmen.

Nga ana e tij, miku nga Kuvajti shprehu kënaqësinë e tij për këtë vizitë dhe vlerësoi bashkëpunimet e deritanishme të Fondacionit kuvajtian “Mercy”, por jo vetëm, në drejtim të përkrahjes së vëllazërve muslimanë në Shqipëri.

Ai tha se është për vizitë në Shqipëri,

MYFTIU PRITI PËRFAQËSUESIN E “MERCY INTERNATIONAL”, KUVAJT



edhe për të marrë pjesë në inaugurimin e xhamisë së re të Mjedës, që me mbarësinë e All-llahut, do të zhvillohet ditën e xhuma, më 26 shkurt 2016, edhe në prani të donatorëve nga Kuvajti.

Gjatë bashkëbisedimit u diskutua edhe rreth forcimit të bashkëpunimit dhe realizimit të projekteve të reja të Myftinisë Shkodër, sidomos ato që lidhen me zhvillimin e vakëfit.

SË SHPEJTI CIKLI I RI I DERSEVE ME TEMË: “FEJA ËSHTË KËSHILLË”

Ditën e martë, më 23 shkurt 2016, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim pune me disa prej imamëve teologë të qytetit të Shkodrës, me të cilët diskutoi detajet e ciklit të ri të derseve me temë: “Feja është këshillë”.

Myftiu tha se gjallërimi i xhamive është një amanet për secilin prej imamëve dhe thirrësve islamë dhe se neglizhenca ndaj xhamisë, xhemateve dhe nevojës së prezantimit të vlerave islame me urtësi dhe në bashkëveprim me njëri-tjetrin, është kthyer në një domosdoshmëri.

Pas diskutimeve dhe mendimeve të dhëna, u vendos që cikli i ri i derseve me temë: “Feja është këshillë”, të zhvillohet pas namazit të akshamit dhe të nisë ditën e hënë, me 29 shkurt 2016, sipas këtij programi:

E hënë, 29. 2. 2016 - xhamia “Ebu Bekër”, ku do të referojnë imamët Durim Kasemi dhe Lavdrim Hamja.

E martë, 1. 3. 2016 - xhamia Dërgut, ku do të referojnë imamët Idmir Plaku



dhe Naim Drijaj.

E mërkurë, 2. 3. 2016 - xhamia Rus, ku do të referojnë imamët Adil Cukali dhe Ervil Kuçi.

E enjte, 3. 3. 2016 - xhamia Kiras, ku do të referojnë imamët Naim Drijaj dhe Ruzhdi Plangaj.

E hënë, 7. 3. 2016 - xhamia Mes-Myselim, ku do të referojnë imamët Ervil Kuçi dhe Durim Kasemi.

E martë, 8. 3. 2016 - xhamia

Perash, ku do të referojnë imamët Lavdrim Hamja dhe Idmir Plaku.

E mërkurë, 9. 3. 2016 - xhamia e Medresesë, ku do të referojnë imamët Adil Cukali dhe Ervil Kuçi.

E enjte, 10. 3. 2016 - xhamia e “Dy Vajzave”, ku do të referojnë imamët Durim Kasemi dhe Naim Drijaj.

Me këtë rast, Myftinia Shkodër ju fton të bëheni pjesë e këtij cikli dersesh me dobi për besimtarët.

KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË
MYFTINIA SHKODËR

CIKLI I DERSEVE ME TEMË:
"FEJA ËSHTË KËSHILLË"

DATA	XHAMIA	LIGJËRUES
E HËNË 29. 2. 2016	"EBU BEKËR"	DURIM KASEMI LAVDRIM HAMJA
E MARTË 1. 3. 2016	DËRGUT	IDMIR PLAKU NAIM DRIJAJ
E MËRKURË 2. 3. 2016	RUS	ERVIL KUÇI DURIM KASEMI
E ENJTE 3. 3. 2016	KIRAS	NAIM DRIJAJ RUZHDI PLANGAJ
E HËNË 7. 3. 2016	MES-MYSELIM	ERVIL KUÇI DURIM KASEMI
E MARTË 8. 3. 2016	PERASH	LAVDRIM HAMJA IDMIR PLAKU
E MËRKURË 9. 3. 2016	MEDRESE	ADIL CUKALI ERVIL KUÇI
E ENJTE 10. 3. 2016	"DY VAJZAT"	DURIM KASEMI NAIM DRIJAJ

MYFTINIA SHKODËR JU FTON TË BËHENI PJESË
E KËTIJ CIKLI DERSESH ME DOBI PËR BESIMTARËT.

(LIGJËRATAT ZHVILLOHEN PAS NAMAZIT TË AKSHAMIT)

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org